

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



APLIKACIONI “DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE” ZËRI I BIZNESIT NË DIASPORË!

Për herë të parë të gjithë sipërmarrësit, intelektualët, bizneset dhe agjentët potencialë të Diasporës Shqiptare do të kenë mundësi të gjejnë një informacion të plotë dhe koherent mbi gjithçka që ka lidhje me investimet dhe potencialet në Shqipëri. Aplikacioni ADBC është krijuar për të ofruar informacion të arritshëm për bizneset, sipërmarrësit, anëtarët e Diasporës në Shqipëri. Ky aplikacion do të ndihmojë vizionin e ADBC të jetë zëri i Shqipërisë dhe komunitetit të biznesit në Diasporë dhe Shqipëri për të promovuar zhvillimin strategjik dhe investimet në Shqipëri duke krijuar një mjedis biznesi tërheqës, aktiv dhe në zhvillim, i cili do të funksionojë pa kufij dhe në marrëveshje me standardet ndërkombëtare të tregut që sigurojnë “një zë” dhe “një përfaqësim” të sipërmarrësve të Diasporës.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



“MËNDJEARTËT 2021”

“Dhoma e Biznesit të Diasporës”, në bashkëpunim me “Unionin e Sipërmarrësve të Rinj” dhe me mbështetjen e “Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës” organizuan ditën e djeshme aktivitetin e ndarjes së çmimeve “Mendje Artët 2021” (Bright Minds – Albanian Awards Entrepreneurship). Fjalën hyrëse e mbajti Kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës, Ardian Lekaj, i cili falenderoi të gjithë bashkëpunëtorët për mundësimin e këtij aktiviteti. Gjithashtu aktivitetin e nderoi me praninë e tij edhe Ministri i Shtetit për Diasporën, Z. Pandeli Majko. Çmimi për investimin më të mirë të Diasporës u njoftua nga Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko i cili përgëzoi organizatorët dhe shprehu konsideratën për të gjithë të nominuarit, për idetë novatore në biznes, investimet e guximshme, shtrirjet në tregjet ndërkombëtare, aplikimin e teknologjive se informacionit dhe cdo arritje ekonomike të tyre “made Albanian”.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



SAMITI I GRAVE TË BIZNESIT NË TIRANË !

Samiti i Grave të Biznesit u zhvillua sot në Tiranë, një aktivitet i organizuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Shtetit për Diasporën, në një format HIBRID . Aktiviteti u përshëndet në hapje nga fjala e Ministrisë së Shtetit për Diasporën z.Pandeli Majko, i cili foli mbi rolin e gruas në biznes, dhe kontributin e grave në Diasporë.Takimi bëri bashkë, gra sipërmarrëse të Diasporës shqiptare dhe të vendit tonë, profesioniste të reja, gra akademike dhe eksperte në fushën e biznesit, përfaqësues të institucioneve shtetërore, si dhe të organizatave ndërkombëtare. Aktiviteti u zhvillua me dy panele “Lidershipi i gruas në Biznes” dhe “Sfidat e Gruas Sipërmarrëse të Diasporës në Situatë Pandemie”.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



JAVA NË LAJME

“GAZETA DIASPORA SHQIPTARE” VLERËSOHET ME ÇMIMIN E VITIT



KOSOVË / NJËZET MILIONË EURO BONO THESARI PËR DIASPORËN



MALI I ZI/ ÇFARË DO TË NDODH ME SIGURACIONI I MJETIT PËR SHQIPTARËT



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104.6	105.2
EUR	122.9	123.5
CHF	110.8	111.6
GBP	143.4	144.4
DKK	16 ^{.22}	16.62